

VENDIM
Nr. 517, datë 29.7.2022

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRIT TË SHTETIT DHE KRYENEGOCIATOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e misionit dhe të fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Misioni i ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator është drejtimi teknik i negociatave dhe bashkërendimi i brendshëm i procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zhvillimit të procesit teknik të negocimit, bashkërendimit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian, bashkërendimit të prioritetëve, hartimit dhe propozimit të politikave, bashkërendimit të kuadrit strategjik të lidhur me anëtarësimin, zhvillimit të kapaciteteve, rritjes së performancës për arritjen e rezultateve, si dhe informimit të publikut për këto procese.

3. Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator ushtron veprimtarinë e tij në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) bashkërendon procesin e brendshëm të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

b) bashkërendon prioritetet e politikave shtetërore dhe politikëbërjen;

c) bashkërendon, harton politikat dhe kuadrin strategjik, në lidhje me anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe i bën propozime Komitetit Shtetëror për Integrimin Evropian;

ç) bashkërendon punën e ministrive të linjës dhe institucioneve të tjera për hartimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian;

d) bashkërendon hartimin e agjendës së reformave në të gjithë sektorët;

dh) kryen negociatat teknike të anëtarësimit në Bashkimin Evropian për të gjithë grup-kapitujt (*clusters*) dhe kapitujt negociues, si dhe bashkërendon punën për përgatitjen e institucioneve shqiptare;

e) bashkërendon dhe ndjek zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian nga institucionet shqiptare, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

ë) bashkërendon dhe ndjek ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendës me atë të Bashkimit Evropian;

f) propozon projektakte, që kanë lidhje me procesin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;

g) ngre mekanizmat metodologjikë, platforma, instrumente dhe mjete të lidhura me negociatat dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si dhe për politikat publike dhe reformat, në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

gj) zhvillon kapacitetet dhe mbështetje për institucionet shqiptare për procesin e negociatave dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe politikëbërjen;

h) bashkërendon punën për hartimin dhe zbatimin e programit për informimin e publikut për çështjet e anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

4. Ngarkohet ministri i Shtetit dhe Kryenegociator për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama